

SHTOJCË e kontratës së integritit

Mirësevini në Flandër dhe faleminderit që merrni pjesë në trajektin e integritit.

Ju jeni të mirëseardhur në Flandër pavarësisht bagazhit tuaj kulturor dhe historikut tuaj të jetës. Por ne presim nga ju që t'i respektoni të drejtat, detyrimet, liritë dhe vlerat e caktuara të cilat janë të rëndësishme për të bashkëjetuar në paqe, në siguri dhe në mirëqënie.

Prandaj është e rëndësishme që, ju të dëshironi të njiheni me këto të drejta, detyrime, liri dhe vlera gjatë trajektit të integritit dhe që ju të jeni të gatshëm për t'i respektuar ato gjithmonë.

Gjatë trajektit të integritit sqarohet:

- çfarë domethënie kanë të drejtat dhe detyrimet thelbësore;
- pse ato janë të rëndësishme në Flandër;
- çfarë domethënie kanë ato në jetën e përditshme;
- cilët hapa mund të ndërmerren nëse ju shkelen të drejtat e juaja apo ato të dikujt tjetër.

Deklaratë

Unë jam i gatshëm/e gatshme të mësoj mbi të drejtat, detyrimet, liritë dhe vlerat në Flandër dhe do t'i respektoj ato. Unë do të respektoj legjislacionin e Komunitetit Flaman dhe të Rajonit Flaman dhe të këtij vendi/shteti.

Të drejta dhe detyrime thelbësore në shoqërinë flamane, që ti duhet t'i respektosh:

- rregulloret belge dhe flamane dhe parimet demokratike të këtij shteti;
- të drejtat e njeriut, siç janë përshkruar në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- lirinë dhe integritetin personal të gjithësecilit. Gjithësecili ka të drejtë të gëzojë liritë themelore, që janë të përcaktuara fuqimisht në Kushtetutën belge. Kjo vlen veçanërisht për:
 - **lirinë e mendimit dhe lirinë e shprehjes së mendimit.** Gjithësecili lejohet të formojë vetë mendimin e tij dhe lejohet të ndajë me të tjerë lirisht bindjet e tij me të folur ose me shkrim. Nxitja për urrejtje apo për dhunë është një veprim i dënueshëm me ligj dhe kjo jep shkas për një dënim nga gjyqtari.
 - **lirinë e mbledhjes/bashkimit.** Gjithësecili është i lirë të bashkohet, por nuk lejohet që dikush të detyrohet të jetë pjesë e një shoqate;
 - **lirinë e besimit fetar.** Gjithësecili lejohet të zgjedhë se cilin besim fetar apo cilën filozofi të jetës ai ndjek. Lejohet gjithashtu që ndonjëri të zgjedhë të mos ndjekë një besim fetar apo filozofi të jetës. Gjithësecili ka të drejtë të ndërrojë besimin fetar ose filozofinë e jetës apo të braktisë besimin fetar;
 - **lirinë e përjetimit të orientimit seksual.** Një marrëdhënie ndërmjet dy burrave apo dy grave është e barazvlefshme si një marrëdhënie ndërmjet një gruaje dhe një burri. Dy gra apo dy burra mund të martohen me njëra-tjetrën/njëri-tjetrin dhe të rrisin fëmijë bashkë.
 - **lirinë e arsimit.** Ofruesit e arsimit janë të lirë të organizojnë arsim dhe t'i japin formë në përmbajtje. Prindërit, nxënësit dhe studentët janë të lirë të zgjedhin arsimin që i përshtatet bindjeve të tyre. Gjithësecili ka gjithashtu të drejtë të arsimohet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore.

- Burrat dhe gratë kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime. Ata japin bashkë kontribut për shoqërinë.
 - Burrat dhe gratë kanë të njëjtat të drejta për arsimim dhe punë.
 - Ata mund të marrin pjesë në procesin demokratik, ku përfshihen zgjedhjet.
 - Si burrat edhe gratë paguajnë taksa.
 - Çdo i rritur zgjedh lirisht një profesion, një vendbanim apo një partner, pa detyrim nga prindërit apo nga familjarët.
 - Në Flandër, të dy prindërit janë përgjegjës për mirëmbajtjen e fëmijëve të tyre dhe ata kujdesen, që fëmijët të marrin arsimimin dhe edukimin më të mirë të mundshëm, në mënyrë që ata të bëhen qytetarë/shtetas aktivë. Të gjithë djemve dhe vajzave u jepen mundësitë e njëjta.
 - Nuk lejohet që djemtë dhe vajzat të detyrohen të martohen.
- Është e dënueshme me ligj të ushtrohet dhunë kundër një bashkëshorti, bashkëshorteje, fëmijëve apo personave të tjerë. Kërcënimi për dhunë është gjithashtu i dënueshëm me ligj në Flandër.
- Flandri dënon shumë rreptësisht çdo veprim terrorizmi.
- Çdo dëshmitar i një tentative për krim, që vë në rrezik jetën e njerëzve të tjerë, apo që don të kërcënojë themelet e shoqërisë, duhet të bëjë gjithçka për t'a parandaluar atë krim dhe duhet të lajmërojë policinë.
- Të integrohesh në shoqëri është gjë e rëndësishme dhe është një kusht për të vazhduar të përfitosh të drejtën e qëndrimit në këtë vend, siç është parashikuar në nenin 1/2, §3 të Ligjit për të Huajt (Vreemdelingenwet).
- Njohja e holandishtes ofron mundësi dhe është gjë thelbësore për të marrë pjesë aktive në shoqëri. Prandaj është e rëndësishme të bëhen përpjekje për të mësuar holandisht.
- Gjykohet që qytetarët dhe familjet janë përgjegjës për të siguruar mjetet e jetesës së tyre. Ne si shoqëri kujdesemi për atë që (përkohësisht) nuk mund të sigurojë mjetet e veta të jetesës, ne presim nga gjithësecili një kontribut për këtë mbrojtje sociale për qytetarët e cënueshëm (në nevojë).